



Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”

**PLANI STRATEGJIK I
UNIVERSITETIT TË MITROVICËS “ISA BOLETINI”
(I RISHIKUAR)
2019-2021**

SHKURTESAT:

GE	Grupi i ekspertëve
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
IMGC	International Multidisciplinary Geo-Science Conference
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KD	Këshilli Drejtues
KP	Komisioni profesional
KQSCV	Komisioni qendror për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit
MAP	Ministria e Administratës Publike
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
NJA	Njësitë Akademike
PA	Parlamenti Studentor
PBNKSH	Prorektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe kërkime shkencore
PMÇSZHC	Prorektore për mësimdhënie, çështje të studentëve dhe zhvillim të cilësisë
PSUMIB	Plani Strategjik i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”
RN	Rezultate të nxënësve
SA	Stafi akademik
SI	Sistemi informativ
TI	Teknologjia informative
THV	Të hyrat vetanake
UMIB	Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
ZBN	Zyra për bashkëpunim ndërkombëtar
ZÇA	Zyra për çështje akademike
ZIKP	Zyra për informim dhe komunikim me publikun
ZP	Zyra e personelit
ZSC	Zyra për sigurim të cilësisë
ZSHS	Zyra për shërbime të studentëve

FJALA E REKTORIT

Të nderuar,

Kam nderin dhe kënaqësinë të prezantoj dokumentin e Planit Strategjik të rishikuar të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, për periudhën kohore 2019-2021, i cili do të përbëjë platformën e qëndrueshme të zhvillimit, kërkimit shkencor ,si dhe inovacionit në këtë institucion.

Në këtë plan strategjik janë dizajnuar objektivat institucionale afatshkurtëra dhe afatmesme, të cilat burojnë nga idetë e menaxhmentit, njësisive akademike, personelit administrativ, studentëve, Bordit Industrial të Universitetit, si dhe palëve tjera të interesit, të cilat janë në përputhje me misionin dhe vizionin e rishikuar.

Plani Strategjik do të jetë udhërrëfyes i Universitetit në rrugëtimin e tij drejt ngritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, zhvillimin e programeve mësimore në përputhje me nevojat e tregut të punës, kërkimit shkencor, ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit, dixhitalizimit dhe informimit public, si dhe menaxhimit të qëndrueshëm financiar.

Zbatimi i Planit Strategjik kërkon sinergjitë e të gjitha palëve të interesit drejt dhënies së kontributit maksimal për zbatimin sa më eficient të tij. Andaj, ftoj personelin akademik dhe administrativ, studentët, institucionet publike, komunitetin e biznesit, si dhe të gjitha palët e tjera të interesit të shfrytëzojnë dhe mbështesin këtë dokument si një plan veprimi drejt arritjes së objektivave strategjike, si dhe identifikimit të mundësive, tejkalimit të vështirësive dhe sfidave që e ardhmja mund të na sjellë.

Me këtë rast, dëshiroj të falenderoj përzemërsisht të gjithë ata që kontribuan në përpilimin e këtij dokumenti me vlerë.

Me respekt,

Prof. dr. Alush Musaj, rektor

HARTIMI I PLANIT STRATEGJIK

Plani Strategjik i rishikuar, për periudhën kohore 2019-2021, është hartuar duke u mbështetur në Standardet dhe Udhëzuesit për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, Ligjin 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statutin e Përkohshëm të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, Standardet e Udhëzuesit të Akreditimit të Agjensionit Kosovar të Akreditimit (AKA) dhe Rekomandimet e Grupit të Ekspertëve Ndërkombëtar, si dhe në konsultimin gjithëpërfshirës të akterëve të jashtëm dhe të brendshëm të Komisionit Profesional, i cili u emërua sipas vendimit numër 2108 të Këshillit Drejtues të UMIB-it, në përbërje prej 21 anëtarëve:

1. Nurten Deva, KD – kryetare,
2. Musa Dibrani, KD – anëtar,
3. Meriton Hajzeri, KD – anëtar,
4. Merita Shala, prorektore – anëtare
5. Ajtene Avdullahi, prorektore – anëtare,
6. Behxhet Shala, prorektor – anëtar,
7. Naser Peci, dekan – anëtar,
8. Besim Gollopeni, dekan – anëtar,
9. Zahir Qerkini, kordinator për zhvillim akademik –anëtar,
10. Albulena Grajçevci, asistente – anëtare,
11. Faton Merovci, profesor – anëtar,
12. Bekim Samadrxha, përfaqësues i MASHT-it - anëtar,
13. Camel SH.P.K., përfaqësues i Bordit Industrial - anëtar,
14. Appetit Group , përfaqësues i Bordit Industrial - anëtar,
15. Bleona Musliu, përfaqësuese e studentëve - anëtare,
16. Edona Haxhimehmeti, përfaqësuese e studentëve - anëtare,
17. Egzona Osmani, përfaqësuese e studentëve - anëtare,
18. Xhelal Smakiqi, sekretar i përgjithshëm - anëtar,
19. Besim Kurti, drejtor për Buxhet dhe Financa – anëtar,
20. Ermira Sopa, përfaqësuese e Zyrës ligjore – anëtare,
21. Avdyll Beqiri, sekretar i Fakultetit Juridik – anëtar.

HISTORIKU DHE PROFILI I UNIVERSITETIT TË MITROVICËS “ISA BOLETINI”

Themelet e studimeve të Arsimit të Lartë në Mitrovicë u vunë me hapjen e Shkollës së Lartë Teknike, në vitin 1961. Në vitin 1970, në kuadër të Fakultetit Teknik u hapën degët e Xehetarisë, Teknologjisë dhe Metalurgjisë, fillimisht në Mitrovicë, viti akademik 1970/71, për të vazhduar pastaj në Prishtinë deri në themelimin e Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë, në vitin 1974. Në vitin e themelimit, studimet u organizuan në këto degë: Xehetari, Teknologji dhe Metalurgji, kurse në vitin akademik 1980/81, u hap edhe dega e Gjeologjisë.

Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë kishte një rëndësi të madhe për Kosovën, por edhe për tërë vendin. Kuadrot e dala nga ky fakultet shquheshin për profesionalizëm dhe zinin vend të merituar në gjigantet si: Kombinati Elektroenergjetik i Kosovës, Kombinati Xehetaro-Metalurgjik “Trepça”, por edhe në tërë industrinë dhe ekonominë e Kosovës e më gjërë.

Qysh nga ditët e para të themelimit, Arsimi i Lartë në Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë ka qenë i ndërkombëtarizuar, bazuar në faktin që studentët që studionin në këtë fakultet vinin nga të gjitha trevat e Kosovës, por edhe më larg, nga viset e tjera me popullatë shqiptare si: nga Maqedonia, Presheva, Bujanoci, Medvegja dhe Mali i Zi, por kishte edhe shumë studentë – shtetas të huaj, e posaçërisht shumica e tyre vinin nga Lindja e Mesme.

Bazuar në traditën rreth 60 vjeçare të Arsimit të Lartë në Mitrovicë, drejtimeve unike, nevojave të tregut të punës, qeveria e Republikës së Kosovës, më 6.3.2013, ka themeluar Universitetin Publik të Mitrovicës, kurse Kuvendi i Kosovës, më 31 maj 2013, ka ratifikuar vendimin. Në bazë të Statutit të Përkohshëm, miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në kuadër të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” funksionojnë gjashtë fakultete.

Fakultetet në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”



Fakulteti i Gjeoshkencave



Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore



Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike



Fakulteti Juridik



Fakulteti Ekonomik



Fakulteti i Edukimit

Në kuadër të këtyre fakulteteve, numri total i programeve të akredituara në UMIB, deri në shtator të vitit 2019, është 20 programe në kuadër të dy niveleve: Bachelor dhe Master.

Programet e ofruara të studimit në nivelin Bachelor dhe Master



Nr.	Programi i studimit Specializimet	Viti i akreditimit	Akredituar deri më	Grada Akademike	ECTS
1.	Teknologji Specializimet: Inxhinieri Mjedisore Inxhinieri Kimike	1.10.2019	30.9.2022	BSc (Niveli VI)	180
2.	Teknologji Specializimet: Inxhinieri e Mbrojtjes Mjedisore Inxhinieri Kimike	1.10.2019	30.9.2022	MSc (Niveli VII)	120
3.	Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore	1.10.2019	30.9.2022	BSc (Niveli VI)	180
4.	Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore	1.10.2019	30.9.2022	MSc (Niveli VII)	120
5.	Inxhinieri ekonomike	1.10.2019	30.9.2022	MSc (Niveli VII)	120
6.	Gjeologji	1.10.2017	30.09.2021	BSc (Niveli VI)	180
7.	Xehetari	1.10.2019	30.9.2022	BSc (Niveli VI)	180
8.	Xehetari	1.10.2019	30.9.2022	MSc (Niveli VII)	120
9.	Biznes dhe Menaxhment me specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet	1.10.2019	30.9.2022	BA (Niveli VI)	180
10.	Materiale dhe Metalurgji Specializimet: Materiale Metalurgji	1.10.2017	30.09.2021	BSc (Niveli VI)	180
11.	Vendbanimet e lëndëve të para minerale	1.10.2019	30.9.2022	MSc (Niveli VII)	120
12.	Hidrogeologji dhe Gjeologji Inxhinierike	1.10.2017	30.09.2021	MSc (Niveli VII)	120
13.	Materiale	1.10.2017	30.09.2021	MSc (Niveli VII)	120
14.	Metalurgji	1.10.2017	30.09.2021	MSc (Niveli VII)	120
15.	Informatikë Inxhinierike	1.10.2017	30.09.2021	BSc (Niveli VI)	180

16.	Makineri Prodhuese	1.10.2017	30.09.2021	BSc (Niveli VI)	180
17.	Inxhinieri Ekonomike	1.10.2017	30.09.2021	BSc (Niveli VI)	180
18.	Juridik	1.10.2017	30.09.2021	LLB (Niveli VI)	240
19.	Edukim Fillor	1.10.2017	30.09.2021	BA (Niveli VI)	240
20.	Edukim Parashkollor	1.10.2017	30.09.2021	BA (Niveli VI)	240

Personeli akademik i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”

Në procesin mësimor në UMIB janë të angazhuar gjithsej 114 mësimdhënës dhe asistentë. Prej tyre në marrëdhënie të rregullt pune janë 95 mësimdhënës dhe 19 mësimdhënës janë të angazhuar. Nga profesorët në marrëdhënie të rregullt pune, 20 profesorë të rregullt, 12 profesorë të asocuar, 28 profesorë asistentë, dhe 33 asistentë dhe 2 ligjërues. Raporti profesor-student në UMIB për këtë vit akademik është 1:16.

Statistika në lidhje me personelin akademik



Personeli akademik bazuar në shkallën e shkollimit

Shkalla e shkollimit	Të rregullt	Të angazhuar	Total
Dr.sc.	61	16	76
Mr / Msc	36	3	38
Total	97	19	114

Personeli akademik bazuar në titujt akademik

	Profesorë të rregullt	Profesorë të asocuar	Profesorë Asistent	Ligjërues	Asistent	Total
Të rregullt	23	13	25	2	34	97
Të angazhuar	6	7	2	1	3	19

Personeli administrativ i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”

Bazuar në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, UMIB e ka të organizuar Administratën Qendrore (AQ) në nivel të rektoratit dhe zyrat administrative në nivel të secilës njësi akademike.

Aktualisht, numri i nëpunësve administrativ në Administratën Qendrore është 17, kurse në zyrat administrative aktualisht janë të punësuar 27 nëpunës administrativ.

Personeli akademik dhe administrativ në AQ dhe NJA


Fakulteti – AQ	Personel akademik i rregullt	Personeli akademik i angazhuar	Personeli administrativ
Fakulteti i Gjeoshkencave	25	6	5
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	19	4	8
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	22	0	9
Fakulteti Juridik	8	3	3
Fakulteti Ekonomik	11	0	2
Fakulteti i Edukimit	12	6	2
Administrata Qendrore			17
Gjithsej	97	19	46

Studentët e Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”

Në Universitetin e Mitrovicës, në kuadër të 6 fakulteteve, në vitin akademik 2019/2020, janë duke vijuar studimet gjithsej 1812 studentë në të gjitha vitet e studimit, në studimet bachelor dhe master.


Falë programeve unike, traditës dhe imazhit, kampusit të ri më modern në vend, cilësisë së mësimdhënies, si dhe numrit të mjaftueshëm të profesorëve, Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” vazhdon të jetë atraktiv për shumë studentë që vijnë nga vendet tjera të Kosovës ku sipas statistikave në nivelin Bachelor vetëm 46.7% e studentëve janë nga Mitrovica.

Pasqyra grafike e studentëve vendor sipas qyteteve në nivelin Bachelor





Ndërsa në nivelin Master kjo përqindje është edhe më e vogël 44.1%.

Pasqyra grafike e studentëve vendor sipas qyteteve në nivelin Master



Sa i përket të diplomuarve tanë, grafika më poshtë, tregon përqindjen e niveleve të punësimit për alumni (ku jo të gjithë studentët tanë të diplomuar janë regjistruar në alumni) dhe përqindja e punësimit të tyre në sektorin publik dhe privat është paraqitur në grafikun në vazhdim:

Përqindja e të punësuarve Alumni të Universitetit dhe përqindja sipas sektorit publik/privat



Kampusi dhe infrastruktura e Universitetit “Isa Boletini”

Universiteti i Mitrovicës, fushëveprimin e saj e realizon në një sipërfaqe prej rreth 18 hektarë. Lokacioni i kampusit shtrihet në ambient mjaft pitoresk, buzë lumit Ibër dhe pranë liqenit artificial, lokalitet ky shumë i qetë dhe i përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë së Arsimit të Lartë, por në të njëjtën kohë paraqet edhe vlerë të shtuar për lokalitet dhe komunën e Mitrovicës.

Kampusi dhe investimet e realizuara krijuan standardet e kërkuara në mësimnxënje dhe ambient të jashtëm. Objektet e ndërtuara kanë një sipërfaqe prej 36.004.31m² (dy objekte të njësive akademike në sipërfaqe prej 33.509 m² dhe objekti i Administratës Qendrore/Rektorati në sipërfaqe prej 2.495 m²). Për vitet 2019/2021, janë siguruar investime për ndërtimin e dy objekteve që do të jenë në shërbim të studenteve: objekti për ushqim dhe objekti për strehimin e studentëve në sipërfaqe prej 7.389m². (Objektet kanë filluar ndërtimin dhe planifikohen të finalizohen në vitin 2021).

Kampusi i Universitetit të Mitrovicës



Objekti i konviktit, do të akomodojë 279 studentë, dhe po ndërtohet në një hapësirë prej 7,896 m² bruto. Objekti do të ketë 4 kate, përdhesë dhe bodrum. Është i dizajnuar për akomodim të studentëve, personelit akademik dhe mysafirëve, përmes 3 grupeve me ndarje vertikale dhe ka bllokun për meshkuj dhe për femra.

Në kuadër të objekteve janë të vendosura laboratorët e njësive akademike: Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe Fakulteti i Gjeoshkencave. Laboratorët të cilët kanë funksionuar në objektet e mëparshme plotësonin standardet e kërkuara në fushat përkatëse. Vlera e pajisjeve të këtyre laboratorëve është 2,500,000.00 € Bartja e pajisjeve (2.500.000.00 €) në laboratorët e objekteve të reja dhe investimet e realizuara gjatë vitit 2019 kanë

krijuar ambiente në përputhje me standardet e kërkuara në fushat e specializimit të njësive akademike. Investimet e realizuar për pajisje për laboratorët e njësive akademike, për vitin fiskal 2019, janë në shumë prej 663,789.57 € që në krahasim me vitin 2018, janë më të larta për 545,961.68 € ose me indeks prej 463.35 %. Në laboratore janë investuar shumat: 97,489.00 € në FIMK; 257,550.00 € në FTU dhe 255,561.10 € në FGJ. Laboratorët e njësive akademike tani plotësojnë standardet e kërkuara dhe studentët përmes aplikimit të mësimit praktik përgatiten për tregun e punës. Në proces të punës së laboratorëve janë siguruar mjete konkretizuese në shumë prej 63,397.98 €. Këto pajisje shërbejnë për procesin e konkretizimit dhe funksionalizimit të laboratorëve.

Investimet e realizuara në vitin 2019, në laboratorët dhe pajisjet laboratorike të fakulteteve në shumë prej 727,186.67 € do të ndikojnë edhe më tej në rritjen e mundësive të studentëve për ushtrime laboratorike dhe punë praktike. Në këtë mënyrë, studentët përveç, përfitimit të njohurive teorike gjatë studimeve, ata në kuadër të ushtrimeve laboratorike dhe punës praktike në laboratorë do të përfitojnë edhe nga puna praktike për zhvillimin profesional në karrierën e tyre.

Përveç laboratorëve që plotësojnë standardet e kërkuara, UMIB, gjithashtu, ka investuar edhe në ngritjen e nivelit të teknologjisë informatike. Pajisjet për teknologji informative janë në funksion, jo vetëm të laboratorëve, por edhe për shërbime tjera që janë në funksion të mësimit. Për këto nevoja, për këtë vit, janë realizuar projekte në shumë prej 131,042.00 € prej tyre në pajisje me kompjuter 98,620.00 €, furnizim me softuer 29,965.00 € dhe mirëmbajtje të teknologjisë informative/SMU 28,457.00 €. Në funksionalizim dhe rregullim të hapësirave (zyrave dhe klasave mësimore dhe laboratorëve) janë realizuar 64,081.00 €. Investime, gjithashtu, janë realizuar për ngritje të komunikimit-VOIP operator në shumë prej 21,183.00 € si dhe vendosjen e perdeve në objektet 1 të njësive akademike dhe Rektorat, në shumë prej 42,898.00 €.

Ambienti dhe investimet në infrastrukturë të jashtme krijuan standarde për rekreacion dhe relaksim të studentëve. Investimet në zonat e gjelbërta, hapësirat dhe shtigjet e ndërtuara, deri në vitin 2018, në vlerë prej 260,000.00 € janë plotësuar me investime shtesë në zona të gjelbërta, në vlerë prej 34,500.00 €. Mjedisi i krijuar është i mirë dhe jep një pamje të një kampusi modern, i cili nuk është tërheqës vetëm për studentët aktualë, por ka kontribuar në një kërkesë në rritje për studime në këtë universitet.

PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Procesi i planifikimit strategjik të Universitetit ka filluar si iniciativë e vetë Universitetit për të rishikuar Planin Strategjik 2018-2021, si dhe në bazë rekomandimeve të Grupit të Ekspertëve Ndërkombëtar për Akreditim dhe KShC.

Komisioni i formuar për rishikimin e Planit Strategjik 2018-2021 (përfaqësues nga Bordi Industrial, studentët, përfaqësues të stafit menaxherial të njësive akademike, përfaqësues të personelit akademik dhe administrativ të UMIB-it) e ka bërë rishikimin e Planit dhe ka dalë me një draft përmbledhës, i cili është përpunuar nga grupi i ngushtë punues i UMIB-it.

Grupi punues, gjatë tërë kohës së hartimit të Planit Strategjik, ka marrë ide dhe sygjerime nga tërë personeli, si dhe palët e tjera të interesit, përfshirë edhe përfaqësuesit e MASHT-it.

Pra, ky Plan Strategjik paraqet një dokument unik, është rezultat i punës ekipore, është zëri i tërë personelit, si dhe palëve tjera të interesit andaj, është i lehtë për t'u kuptuar dhe përdorur nga të gjitha palët, por edhe për lexuesin e jashtëm.

Para rishikimit të Planit Strategjik me të gjithë akterët e brendshëm dhe të jashtëm është diskutuar misioni i Universitetit, i cili ka shërbyer edhe si udhërrëfyes për objektivat strategjike të Universitetit.

Plani strategjik është hartuar në harmoni me vizionin, misionin dhe duke marrë për bazë:


- *Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 të qeverisë së Kosovës,*
- *Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, 2010,*
- *Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021,*
- *Statutin e Përkohshëm të UMIB-it dhe*
- *Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve 2011,*

Misioni i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” është që të ofrojë mësimdhënie cilësore për përgatitjen e kadrove në fusha unike për Kosovën, rajonin e më gjerë, i dedikuar të zhvillojë kërkime shkencore, projekte profesionale, këshillime profesionale duke qenë në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe rritjes së mirëqenies dhe avancimit shoqëror.

Vizioni i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” është të jetë Institucion i Arsimit të Lartë lider në rajon, në edukim dhe hulumtim shkencor, për përgatitjen e kadrove konkurrentë në fusha unike për Kosovën dhe rajonin, për të përmbushur kërkesat e së tashmes dhe projektuar nevojat e së ardhmes, për nevojat shkencore-akademike, të ekonomisë së tregut, institucioneve e diplomacisë, i fokusuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien sociale.

Vlerat mbi të cilat mbështetet veprimtaria e i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” dhe mbi të cilat është hartuar Plani Strategjik 2019-2021 udhëhiqen në drejtim të përmbushjes së misionit dhe vizionit të saj. Universiteti promovon vlerat universale, grupore dhe individuale.

Vlerat mbi të cilat mbështetet veprimtaria e Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”



Palët e interesit

Zhvillimi strategjik i Universitetit të Mitrovicës, për periudhën 2019-2021, planifikohet të zbatohet në bashkëveprim dhe bashkëpunim të ngushtë me të gjitha palët e interesit. Resurset humane paraqesin pasurinë më të rëndësishme të Universitetit andaj, personeli akademik, administrativ dhe teknik, si dhe menaxhmenti i Universitetit janë listuar më së larti në grupin e palëve të interesit.

Personeli akademik - janë bartësit kryesorë të procesit mësimor efektiv, këshillimit akademik dhe këshillimit të studentëve, si dhe janë përgjegjës për zhvillimin e vazhdueshëm të kurrikulës përmes vlerësimit, veprimtarisë studimore, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë grup interesi përfshihen profesorët e rregullt, profesorët e angazhuar, asistentët dhe bashkëpunëtorët shkencor. Sipas thirrjes akademike, personeli akademik ka këtë përbërje: Prof. dr., Prof. asoc. dr., Prof. ass. dr., Ass. dhe Ligjërues.

Personeli administrativ dhe teknik - përbëjnë palët e brendshme të interesit të cilët kryejnë funksionet operationale dhe administrative të Universitetit, administrimin e fakulteteve dhe departamenteve, marrëdhëniet me publikun dhe marketingun dhe shërbimet studentore. Në këtë grup interesi përfshihen: sekretari i përgjithshëm dhe sekretarët e njësive akademike, drejtorët e zyrave, zyrtarët e administratës, bibliotekistët dhe personeli teknik.

Menaxhmenti i Universitetit - Menaxhmenti i Universitetit përbën organet udhëheqëse dhe vendim-marrëse që përkujdesen për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës edukative, kërkimit shkencor, sigurimit të cilësisë, bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe menaxhimin financiar. Në këtë grup interesi bëjnë pjesë: Këshilli Drejtues, Senati, rektori, prorektorët, dekanët, prodekanët dhe shefat e departamenteve.

Studentët - Studentët paraqesin palën më thelbësore të interesit për zhvillimin e Universitetit. Suksesi i karrierës postakadematike të studentëve reflekton në Universitetin ku ata kanë vijuar studimet, andaj, studentët konsiderohen pala kryesore e interesit në Universitet. Vlerësimet dhe sygjërimet e studentëve paraqesin forcat lëvizëse drejt suksesit të përgjithshëm të Universitetit. Këtë grup të interesit e përbëjnë studentët e rregullt nga të gjitha trevat e Kosovës.

Alumni - janë studentët e diplomuar, të cilët Universiteti i sheh si një aset të pashmangshëm dhe të një rëndësie të veçantë. Universiteti ka themeluar Shoqatën Alumni, e cila shërben si urë lidhje në mes studentëve aktual, personelit akademik dhe administrativ, Alumnit, si dhe komunitetit të jashtëm. Universiteti vazhdon ofrimin e shërbimeve ndaj këtij grupi të interesit, si dhe i mban të informuar dhe të interesuar për zhvillimin e vazhdueshëm të Universitetit dhe mundësive për bashkëpunim.

Komuniteti i biznesit - përbëhet nga përfaqësuesit e industrisë, Oda Ekonomike e Kosovës, bizneset lokale, por dhe ato ndërkombëtare, dhe paraqet palë strategjike të interesit. Me qëllim rritjes së bashkëpunimit me këtë palë interesi, Universitetit ka themeluar Bordin Këshilldhënës, si dhe planifikon krijimin e Bordeve Këshilldhënëse edhe në të gjitha njësitë e tij akademike.


Autoriteti qeveritar lokal dhe qendror - në këtë grup të palës së interesit përfshihen përfaqësuesit e Kuvendeve Komunale të rajonit të Mitrovicës, MASHT-i, Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike, etj. Ky grup ka rëndësi mjaft të madhe drejt zbatimit të Planit Strategjik, por edhe në historikun dhe zhvillimin e Universitetit, si dhe Arsimit të Lartë në përgjithësi.

Komuniteti i jashtëm akademik dhe shkencor - përbëhet nga partnerët e jashtëm strategjik të Universitetit. Këtij grupi i takojnë universitetet bashkëpunuese në Kosovë dhe jashtë, institutet kërkimore-shkencore, si dhe shkollat e mesme dhe institucionet e tjera, të cilat e ndihmojnë Universitetin në ngritjen e kapaciteteve akademike, kërkimore dhe shkencore.

Objektivat strategjike

Plani Strategjik identifikon objektivat strategjike të zhvillimit të Universitetit për periudhën afatmesme 2019-2021 të zhvillimit.

Objektivat strategjike



Plani Strategjik përmban në vete Planin e veprimit. Në kuadër të Planit të veprimit janë paraqitur objektivat strategjike, objektivat specifike, si dhe janë planifikuar aktivitetet, afatet kohore të zbatimit, përgjegjësitë dhe kostot e financimit.

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit me efikasitet dhe monitorimit të Planit Strategjik, plani i veprimit përmban edhe indikatorët (treguesit) kryesorë të performancës, si dhe rezultatet (caqet) e pritura, të cilat i lehtësojnë bartësve të aktiviteteve, si dhe grupit monitorues matjen e performancës së secilit aktivitet, objektivë specifike dhe strategjike.

SWOT ANALIZA

Fuqitë	Dobësitë
<ol style="list-style-type: none"> 1. Programe studimi unike, cilësore dhe atraktive, 2. Gatishmëria e menaxhmentit në mbështetjen e iniciativave në rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, 3. Kampusi më i ri dhe më modern në vend, i pajisur me laboratore moderne, me vendodhje në qytet dhe pamje piktoreske buzë liqenit, 4. Numër i mjaftueshëm i stafit akademik (raporti profesor - student 1:16), 5. Vendodhja e të gjitha NJA brenda hapësirës së kampusit, mundësi bashkëpunimi kërkimoro- shkencor, si dhe komunikimi efikas. 6. Kosto e ulët dhe e përballeshme e studimit për studentët, 7. Përkrahje financiare e stafit akademik në kërkim shkencor nga Universiteti, 8. Përfshirja e studentëve në të gjitha strukturat vendimmarrëse në UMIB, 9. Konsultimi i gjerë me komunitetin e biznesit, studentët Alumni dhe punëdhënësit e tyre, 10. Gatishmëria e stafit për bashkëpunim me studentët. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shërbim ende i pazhvilluar i orientimit dhe këshillimit në karrierë (Qendra është në fillim të funksionimit), 2. Mungesa e programeve të doktoratës, 3. Kufizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mobilitetit për shkak të regjimit të vizave, 4. Integrimi i pamjaftueshëm i kërkimeve shkencore në mësimdhënie, 5. Aktualisht shërbime të kufizuara në aktivitete sportive për studentët.
Mundësitë	Rreziqet
<ol style="list-style-type: none"> 1. Rritja e fondeve nga BE për Arsimin e Lartë, 2. Rritja e fondeve të MASHT-it për kërkime shkencore, 3. Pavarësi e plotë institucionale në aspektin operacional, organizativ dhe financiar, 4. Sigurimi i mundësive për programe të reja, sipas interesave lokale dhe kombëtare, 5. Trajnimi i stafit me metodologjitë e mësimdhënies në Arsimin e Lartë, 6. Përkushtimi i vazhdueshëm i komunitetit të donatorëve (mundësi për shkëmbim), 7. Trend pozitiv i bashkëpunimit me komunitetin afarist, 8. Hapja e programeve studimore në gjuhën angleze, 9. Rritja e bashkëpunimit Universitet – Industri. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndryshimet demografike dhe emigrimi i të rinjve, 2. Varësi institucionale nga MASHT-i, 3. Akreditimi institucional i universitetit, 4. Konkurrenca jolojale nga kolegjet private, 5. Largimi i stafit akademik nëpër universite të tjera, 6. Prolongimi i vendimeve nga Kuvendi i Kosovës për aprovimin të vendimeve strategjike (Statutit), 7. Burime të kufizuara financiare për kërkime shkencore.

PLANI I VEPRIMIT

Objektiva strategjike: 1. Mësimdhënia dhe zhvillim profesional					
Objektiva specifike 1.1. Përmirësimi i metodave të mësimdhënies					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kosto financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
1.1.1 Organizimi i trajnimit për metodologjitë e reja të mësimdhënies	PMÇSZHC, Zyra për buxhet dhe financa.	3,000.00 €	Trajnimet e organizuara	2020	105 certifikata
1.1.2 Trajnim i avancuar për metodologjitë e M.	PMÇSZHC, Zyra për buxhet dhe financa.	3,000.00 €	Trajnimet e organizuara	2021	105 certifikata
1.1.3 Trajnim për shqyrtimin e syllabuseve	PMÇSZHC, Zyra për buxhet dhe financa.	300.00 €	Trajnimet e organizuara	2020	80% e stafit aktual të trajnuar
1.1.4 Përshtatja e syllabuseve me zhvillimet në domenin specifik	Stafi akademik, Dekanatet, PMÇSZHC.	Shpenzime administrative	Numri i syllabuseve të shqyrtuara	2020	30% e syllabuseve të përditësuara
Objektiva specifike 1.2. Harmonizimi i metodës së vlerësimit me rezultatet e pritura të të nxënit					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
1.2.1 Hartimi i manualit të vlerësimit me rezultatet e pritura të të nxënit	PMÇSZHC	Shpenzime administrative	Manuali i gatshëm për përdorim	2020	Manuali i publikuar në web-faqen e UMIB-it
1.2.2 Aplikimi i ndryshimeve në hartimin e syllabuseve	PMÇSZHC	Shpenzime administrative	Numri i syllabuseve të ndryshuara	2020 -2021	Syllabuset janë ndryshuar për të reflektuar politikat e reja

Objektiva specifike 1.3 Vendosja e sistemit anti-plagjiat					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
1.3.1 Trajnimi i stafit për softuere për anti-plag. dhe aplikimi i softuerit	Zyra TI	Shpenzime administrative	Trajnimi i organizuar i stafit	2020	Stafi i trajnuar dhe 50% e punimeve të stafit dhe studentëve i nënshtrohen sistemit antiplagjiat
1.3.2 Monitorimi i shfrytëzimit të sistemit	PMÇSZHC, Zyra e TI	Shpenzime administrative	Pasqyrimi i të dhënave nga shfrytëzimi i sistemit	2020-2021	Raportet periodike çdo 6 muaj
Objektiva specifike 1.4. Ndërtimi dhe funksionalizimi i një sistemi llogaridhënës					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
1.4.1 Krijimi i instrumenteve të llogaridhënies	PMÇSZHC, ZSC.	Shpenzime administrative	Paketë e instrumenteve të llogaridhënies	2020	Politikat e mësimdhënies të ndryshuara
Objektiva specifike 1.5 Aftësimi i vazhdueshëm i stafit					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
1.5.1 Ndjekja e një konference në fushën speciale	PMÇSZHC, PBNKSH, Zyra për buxhet dhe financa.	5,000.00 €	Numri i pjesëmarrjeve	2020-2021	Së paku 70% e stafit kanë ndjekur një konferencë gjatë vitit
1.5.2 Publikimi i së paku një artikulli në vit	PMÇSZHC, PBNKSH, Zyra për buxhet dhe financa.	5,000.00 €	Numri i publikimeve	2020-2021	Së paku 70% e stafit kanë publikuar një artikull gjatë vitit
1.5.3 Mbështetja për kalim nga MA në PhD	PMÇSZHC, Zyra për buxhet dhe financa.	20,000.00 €	Numri i stafit të mbështetur	2020-2021	5 anëtarë të stafit janë mbështetur

1.5.4 Aplikimi i stafit për pjesëmarrje në mobilitete	Këshilli Drejtues, PMÇSZHC, PBNKSH.	Fonde të projekteve (Erasmus +,etj)	Numri i aplikimeve të stafit	2020-2021	Së paku 10 anëtar të stafit kanë aplikuar
Objektiva specifike 1.6. Harmonizimi i rezultateve të të nxënit të lëndëve me rezultatet e programit					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
1.6.1 Hartim i raportit mbi përshtatjen e RN të lëndëve me RN të programit	Komisioni i Studimeve	Shpenzime administrative	Përqindja e p[rshtatjes së RN të lëndëve me rezultatet e programit	2020	Raporti i publikuar
1.6.2 Organizimi i një punëtorie për stafin akademik për përshtatjen e RN të lëndëve me RN të programit	Komisioni i Studimeve	300.00 €	Zhvillimi i punëtorisë	2020	Punëtoria e organizuar
1.6.3 Programet në proces të riakreditimit të rishikuara sipas udhëzimeve të Komisionit të Studimeve	Komisionet e Studimeve në fakultete, Komisioni i Studimeve ne Universitet.	Shpenzime administrative	Numri i programeve të rishikuara	2020	Programet e rishikuara
Objektiva specifike 1.7. Harmonizimi i rezultateve të të nxënit të lëndëve me kornizën e kualifikimeve kombëtare					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
1.7.1 Mbajtja e një punëtorie informuese	PMÇSZHC	150.00 €	Zhvillimi i punëtorisë	2020	Punëtoria e organizuar
1.7.2 Shqyrtimi i rezultateve të të nxënit në syllabuse	Stafi akademik, Dekanatet, PMÇSZHC.	Shpenzime administrative	Numri i syllabuseve të shqyrtuara	2020-2021	35% e syllabuseve janë rishikuar çdo vit

Objektiva specifike 1.8 Burimet e mësimit dhe mbështetja					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
1.8.1 Hartimi i pyetësorëve për vlerësimin e shërbimeve administrative nga stafi akademik.	ZSC	Shpenzime administrative	Pyetësoni i zhvilluar	2019	Pyetësoni i hartuar
1.8.2 Hartimi i pyetësorëve për vlerësimin e shërbimeve administrative nga studentët	ZSC	Shpenzime administrative	Pyetësoni i zhvilluar	2019	Pyetësoni i hartuar
Objektiva specifike 1.9 Orientimi dhe informimi për të gjitha fazat e ciklit të jetës studentore					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
1.9.1.Hartimi i doracakut për studentë me informatat më relevante që kanë të bëjnë me Fakultetet dhe programet e studimit.	ZSHS	Shpenzime administrative	Doracaku i hartuar	2019-2020	Doracaku i publikuar në web-faqe
1.9.2 Kampanjë informuese për maturantët	ZSHS, Parlamenti studentor.	300.00 €	Numri i aktiviteteve të kampanjës	2020	20 aktivitete të realizuara

Objektiva strategjike: 2. Hulumenti Shkencor

2.1. Hartimi i planit strategjik të kërkimeve shkencore

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
2.1.1. Formimi i grupit punues dhe hartimi i planit strategjik të kërkimeve shkencore	PBNKSH, Rektorati.	Shpenzime administrative	Hartimi dokumentit: “Plani Strategjik për kërkime shkencore”.	2020	Planit Strategjik për kërkime shkencore i hartuar.
2.1.2. Themelimi i instituteve kërkimore në njësi akademike	NJA	Shpenzime administrative	Themelimi i një instituti në kuadër të një NJA.	2020	Instituti i themeluar në një NJA.
2.1.3. Funkcionalizimi i zyrës për kërkime shkencore	PBNKSH, Rektorati.	3,000.00 €	Emërimi i një Koordinatori qendror për kërkime shkencore.	2020	Koordinatori qendror i emëruar për kërkime shkencore.

2.2. Krijimi i fondit nga të hyrat financiare për përkrahje të hulumtimit

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
2.2.1. Ndarja e një fondi nga të hyrat vetanake të UMIB	Rektorati, Fakultetet.	20,000.00 €	Punime shkencore dhe konferenca të financuara	2021	Së paku 70% e stafit kanë marrë pjesë në konferencë dhe kanë publikuar një punim gjatë vitit
2.2.3. Aplikimi për përkrahje nga skemat e ndryshme të MASHT-it dhe partneritet në projekte të përbashkëta ndërkombëtare	Instituti kërkimor, NJA, prorektorët, stafi akademik dhe studentët.	Shpenzime administrative	Aplikimet për projekte dhe përkrahje	2020-2021	50 aplikime

